



**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA**

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



UDHËZIM ADMINISTRATIV

No. 01/2005, Data .02.2005

MBI

ZBATIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut Nr. 2004/51

‘MBI

TATIMIN NË TË ARDHURA TË KORPORATAVE’

Ministria e Financave dhe Ekonomisë nxjerr kete Udhëzimin Administrativ për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/51 “Mbi Tatimin në të Ardhura të Korporatave”:

Neni 1
Përkufizimet

‘*Divident*’ është definuar në Nenin 1.(b) të Rregullores. Qoftë apo jo një distribucion një dividend do të bazohet vetëm në përkufizimin e dhënë në Rregullore pa marrë parasysh se a ka realizuar fitime entiteti apo jo gjatë periudhave tatimore të tanishme apo të kaluara.

‘*Veprimtari ekonomike*’ është definuar në Nenin 1.(c) të Rregullores si çdo lloj i aktivitetit në të cilin është hyrë për qëllim të realizimit të të ardhurave, çfarëdo qoftë rezultati i veprimtarisë. Zakonisht, qëllimi për fitim dhe qëllimi jofitimprurës i veprimtarisë është cekur në statutin dhe aktin e themelimit të entitetit. Nëse një organizatë biznesi që është themeluar për qëllim fitimi realizon humbje, ende mbetet e përfshirë në veprimtari ekonomike. Nëse një organizatë jofitimprurëse që është themeluar për qëllim të përfitimit publik realizon një fitim përmes veprimtarisë së biznesit që lidhet me veprimtarinë e saj parësore të përfitimit publik dhe e cila papë është shfrytëzuar për t’i shërbyer përfitimit publik, për qëllime të këtij Udhëzimi Administrativ, nuk nënkupton se është përfshirë në veprimtari ekonomike.

‘*Rregullore*’ nënkupton Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/51 ‘Mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave’.

Neni 2

Të ardhurat e përjashtuara nga tatimi

Neni 6.(c) I rregullores përjashton nga tatimi në të ardhura të korporatave dividendet e marra nga një tatimpagues rezident prej tatimpaguesit tjetër rezident i cili ka paguar tatimin në të ardhurat e korporatave në Kosovë. Fraza *'e marrë nga një tatimpagues rezident'* nënkupton se marrësi i dividendit poashtu duhet të jetë një person që i nënshtrohet tatimit në të ardhura të korporatave ose paraardhësit të tij, tatimit në fitim. Nuk nënkupton tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit në të ardhura personale.

Të ardhurat e gjeneruara nga BPK, TKPK, AKM dhe Qeveria poashtu janë të përjashtuara dhe kështu që nuk do të mbahet në burim tatim mbi interesin, dividendën, të ardhurat nga qiraja dhe të ardhurat e tjera të trupave të sipërpërmendur.

Neni 6.(d) përjashton nga tatimi në të ardhura të korporatave të ardhurat e kontraktorëve jovendor të gjeneruara nga kontratat me KB, UNMIK-un, agjencionet e specializuara të KB dhe IAEA. Shprehja *'ndryshe nga kontraktori vendor'* nënkupton kontraktorët e themeluar jashtë Kosovës të cilët nuk kërkohet të regjistrojnë një njësi të përhershme në Kosovë. Nëse një kontraktor jovendor kryen veprimtari tjera në Kosovë, përveç atyre për KB, UNMIK-un, agjencionet e KB dhe IAEA, duhet të regjistrojë një njësi të përhershme në Kosovë dhe të ardhurat e gjeneruara nga kjo njësi e përhershme përfshihen në të ardhurat bruto të tatimpaguesit.

Neni 3

Shpenzimet e lejueshme

Në përputhje me Nenin 7 të Rregullores, tatimpaguesit i lejohe të zbrësë nga të ardhurat bruto shpenzimet e paguara ose të kryera gjatë periudhës tatimore gjatë veprimtarive ekonomike. Për të lejuar si zbritje, të gjitha shpenzimet duhet të jenë në tërësi të dokumentuara dhe dokumentacioni mbështetës sikurse janë kontratat, faturat, deklarat e doganës, kuponat, dokumentet e pagesës, dokumentet bankare, regjistrimet e listës së pagave, biletat, dëftesat, urdhër transferet dhe dokumente tjera përkatëse duhet të jenë të gatshme për inspektim me kërkesën e Administratës Tatimore.

Neni 4

Shpenzimet e palejueshme

Neni 8 i Rregullores merret me shpenzimet e palejueshme. Shpenzimet vijuese nuk lejohen si shpenzim:

- a. *Kostoja e blerjes dhe përmirësimit të tokës.* Si parim, toka nuk e humb vlerën e saj me kohën dhe nuk vjetërsohet. Toka lehtë mund të konvertohet në para të gatshme. *'Përmirësim'* nënkupton punën që rrit vlerën e tokës dhe përfshin punën e dranazhit, terracimin, kanalizimin dhe pajisjen me tubacione ujitesë dhe punë tjera të ngjashme të cilat bëhen pjesë e tokës dhe të cilat rrisin vlerën e përgjithshme të tokës.
- b. *Kosto e blerjes së aseteve të amortizueshme dhe të zhvlerësueshme.* Shpenzimet e tilla mbulohen gjatë kohës përmes lejimeve për amortizimim dhe zhvlerësimim.

- c. *Gjobat dhe ndëshkimet.* Shpenzimet e tilla dalin kur tatimpaguesit shkelin rregullat tatimore apo rregullat dhe kerkesat e tjera të aplikueshme. Ato do të paguhen nga fitimi pas tatimit.
- d. *Tatimet në të ardhura.* Pagat bruto, të cilat përfshijnë tatimin në të ardhura personale të mbajtur në burim nga të punësuarit, përbëjnë një shpenzim, pra janë të zbritshme. Tatimi në të Ardhura të Korporatave nuk është i zbritshëm pasi llogaritet pas zbritjes së të gjitha shpenzimeve të lejuara.
- e. *TVSh e zbritshme* nuk është shpenzim i zbritshëm nëse është rikthyer ose kredituar nga TVSh e llogaritur. Në një rast të veçantë ajo është e zbritshme dhe kjo ndodh kur një tatimpagues i tatimit në të ardhurat e korporatave nuk e ka arritur pragun e regjistrimit për TVSh dhe kështu nuk ka të drejtë të aplikojë TVSh në furnizimet vendore.

Neni 5

Kontributet bamirëse

Në Nenin 9.1 të Rregullores, shprehja *‘të llogaritura para se shpenzimet të jenë zbritur’* nënkupton se 5% limiti i lejuar do të aplikohet në fitimin bruto përpara se një shpenzim të jetë zbritur nga të ardhurat bruto të korrigjuara. P.sh. nëse një kompani ka një fitim bruto përpara kontributeve bamirëse prej 10,000 euro dhe ka bërë një donacion një spitali prej 400 euro, 5% limiti i lejuar do të aplikohet në 10,000 euro dhe jo në $10,000 - 400 = 9,600$ euro. Në këtë rast 400 euro në tërësi është e zbritshme meqë është brenda limitit të lejuar të $10,000 \times 5\% = 500$ euro.

Forma e dëftesës që duhet të dorëzohet sipas Nenit 9.4 të Rregullores së bashku me Pasqyrat Financiare dhe Deklaratën e Tatimit në të Ardhurat e Korporatave në ATK është dhënë këtu poshtë:

Dëftesa e Kontributeve Bamirëse

1. Emri i donatorit	[1]
2. Numri ID i donatorit	[2]
3. Adresa e donatorit	[3]
4. Emri i personit kontaktues dhe telefoni	[4]
5. Emri i marrësit	[5]
6. Numri ID i marrësit	[6]
7. Adresa e marrësit	[7]
8. Emri i personit kontaktues dhe telefoni	[8]
9. Shuma e kontributeve bamirëse të dhuruara	[9]
10. Data e donacionit	[10]

Me këtë deklaroj se të dhënat e deklaruarat më lartë janë të vërteta dhe të sakta. Marrësi nuk ka ndonjë konflikt të interesit direkt apo indirekt me donatorin.

Emri dhe nënshkrimi i personit të caktuar
(_____)

dd/mm/vvvv
//_

Neni 6

Shpenzimet e përfaqësimit

Shprehja 'të ardhurat bruto totale' në Nenin 10 të Rregullores nënkupton të gjitha të ardhurat që kanë lindur gjatë periudhës tatimore nga burime mbrenda në Kosovë dhe përfshinë të ardhura nga veprimtaritë e biznesit, të ardhura nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme, të paluajtshme, të patrupëzuar, të ardhurat nga interesi, të ardhurat nga dividendët, fitimet nga shitja e letrave me vlerë apo pasurisë së paluajtshme dhe çdo të ardhur tjetër që nuk është përfshirë në mënyrë të veçantë më lartë.

Neni 7

Pagesat për personat e lidhur

Neni 13 i Rregullores parasheh që kompensimi, shpërblimet, interesi, qiraja dhe shpenzimet tjera të paguara për personat e lidhur do të lejohen si një zbritje në një shumë të barabartë me më të voglën e shumës së paguar dhe vlerës përkatëse e tregut. P.sh. djali i pronarit të një kompanie është i punësuar nga kompania si shofer dhe paguhet 2,000 euro/muaj. Vlera e tregut për shërbime punësimi si shofer është 400 euro. Kjo është shuma që do të lejohet si një zbritje meqë shoferi dhe kompania janë persona të lidhur. P.sh. kompania A dhe B janë në pronësi të të njëjtit individ dhe A i lëshon me qira një depo B për 1,000 euro/muaj. Vlera e tregut për një shërbim të tillë të qirasë është 1,800 euro. Vetëm 1,000 euro do të lejohen si shpenzim i zbritshëm meqë A dhe B janë persona të lidhur.

Neni 8

Amortizimi

Shprehja në Nenin 14.1 të Rregullores 'në pronësi të tatimpaguesit' nënkupton se vetëm pronari i pasurisë së trupëzuar, i cili mbart rrezikun e vjetërsimit, shkatërrimit ose papërdorimit të asetit, ka të drejtën të zbrisë zbritjet e amortizimit. Nuk do të lejohet zbritje amortizimi për marrjen me qira të aseteve përveç nëse është cekur në marrëveshjen e qirasë që një qira financiare është e përfshirë dhe të drejtat e pronësisë kalojnë në qiramarrësin nga qiradhënësi përmes pagesave periodike.

Sipas Nenit 14.2 të Rregullores, shpenzimet e qiramarrësit në përmirësimet e objekteve të marra me qira do të mbulohen përmes zbritjeve të amortizimit duke përdorë metodën e lineare bazuar në kohëzgjatjen e kontratës së qirasë. Në rast të qiramarrjes me afat të hapur apo kur jeta e marrjes me qira ndryshohet shpesh, qiramarrësi, sipas gjykimit të tij më të mirë dhe bazuar në rregullat e kontabilitetit dhe praktikën më të mirë, do të definojë kohëzgjatjen e marrjes me qira dhe të përdorë atë si emërues për llogaritjen e ngarkesës vjetore të amortizimit për përmirësimin e kryer.

Neni 14.5 i Rregullores parasheh për amortizim përdorimin e 'Metodës së Balances Zvogëluese'. Shembujt për këtë metodë janë:

Kategoria 1, Llogaria e kapitalit të veçar: (5% e vlerës të secilit aset në fund të periudhës tatimore)

Të supozojmë se kompania X në fillim të periudhës tatimore 2005 posedon një ndërtesë prej 1,000,000 euro, që i përket Kategorisë 1 të asetëve të amortizueshme. Metoda e balancës zvogëluese punon si vijon:

Periudha tatimore	Bilanci i hapjes	Shtesat	Amortizimi	Bilanci i mbylljes
2005	1,000,000 euro	-	50,000	950,000
2006	950,000 “	-	47,500	902,500
2007	902,500 “	-	45,125	857,375
.....				
.....				
.....				

Kategoria 2 Asetet e grupuara (20% e vlerës së grupit në fund të periudhës tatimore)

Të supozojmë se kompania X në fillim të periudhës tatimore 2005 posedon asetet vijuese që i përkasin Kategorisë 2: 10 kompjutera - 1,000 euro secili; 2 fotokopjues-4,000 euro secili; 2 automobila- 10,000 euro secili. Në periudhën tatimore 2005 kompania blen një kompjuter tjetër prej 2,000 euro. Në periudhën tatimore 2006 kompania shet një automobil për 8,000 euro. Metoda e zvogëluese e bilancit punon si vijon:

Periudha tatimore	Bilanci i hapjes	Shtesat	Uljet	Amortizimi	Bilanci i mbylljes
2005	38,000	2,000	-	8,000	32,000
2006	32,000	-	8,000	4,800	19,200
2007	19,200	-	-	3,840	15,360
...					
...					
...					

Neni 14.6 i Rregullores parasheh që asetet se pari do të merren parasysh për qëllime amortizimi vetëm kur ato të jenë vënë në përdorim. Nuk do të lejohet zbritje amortizimi nëse një aset nuk është vënë në përdorim dhe nëse nuk shërben për qëllim të veprimtarisë ekonomike.

Neni 9

Lejesa speciale për asetet e reja

Neni 15.1 i Rregullores parasheh që asetet e reja që i përkasin Kategorisë 3, të blera të reja mbrenda apo të importuara për të parën herë në Kosovë në mes të 1 Janar 2005 dhe 31 Dhjetor 2008, përfitojnë një lejesë speciale prej 10% përveç zbritjes normale të amortizimit të lejuar të grupit. P.sh., të supozojmë se Kompania X ka një bilanc të hapjes të Kategorisë 3 për periudhën tatimore 2005 prej 160,000 euro. Gjatë vitit kompania importon nga Gjermania një kamion të madh transportues të ri prej 40,000 euro. Zbritja e amortizimit për këtë periudhë tatimore do të ketë dy komponente: 1. amortizimin normal të grupit: $200,000 \times 15\% = 30,000$ euro; 2. Lejesën speciale për asetin e ri: $40,000 \times 10\% = 4,000$ euro. Totali i zbritjes së amortizimit $30,000 + 4,000 = 34,000$ euro. Lejesa speciale për asetet e reja jepet vetëm një herë, në periudhën tatimore në të cilën aseti është blerë apo është sjellur në Kosovë.

Neni 10

Riparimet dhe përmirësimet

Neni 16 i Rregullores merret me riparimet dhe përmirësimet. Termi '*riparimet dhe përmirësimet*' nënkupton punën që është bërë për të rritur shumë kapacitetin, jetën, kushtet dhe produktivitetin e asetit. Në rastin e ndërtesës, vënia e kulmit, instalimet e hidraulikut, suvatimet dhe punë tjera të ngjashme konsiderohen riparime dhe përmirësime, por ngjyrosja nuk është e tillë. Në rastin e një kamioni, ndërimi i gomave nuk është përmirësim, por zëvendësimi i motorit ekzistues me të ri, është riparim dhe përmirësim. Pragu 5% për kapitalizim ose zbritja e mënjëhershme e shpenzimeve të përmirësimit dhe riparimit aplikohet si vijon: Të supozojmë se bilanci i hapjes të një ndërtese është 100,000 euro. Gjatë periudhës tatimore tatimpaguesi riparon kulmin për një vlerë të barabartë me 5,500 euro. 5,000 euro që është mbrenda limitit të lejuar do të kërkohet si një shpenzim dhe teprica prej 500 euro do të shtohet në llogarinë kapitale të veçantë dhe do të amortizohet së bashku me ndërtesën.

Neni 11

Kostot e eksplorimit dhe zhvillimit

Neni 18 i Rregullores parasheh për zhvlerësimin e një depoziti natyral të mineraleve dhe burimeve tjera natyrore. Shfrytëzuesi i depozitit mund të kërkojë zbritje për kostot e eksplorimit dhe zhvillimit. Kostot e eksplorimit, kostot e zhvillimit dhe interesi i ndërlidhur me to duhet të shtohen në një llogari kapitale ashtu sikurse kane lindur. Në fund të periudhës tatimore, pjesa e kostove të eksplorimit dhe zhvillimit që i përkasin asaj periudhe do të përcaktohet duke shumëzuar bilancin në llogarinë kapitale me koeficientin e amortizimit (KA) e që është:

Numri i njësive të nxjerra gjatë vitit
KA= _____

Totali i njësive të vlerësuara në deposite

Shembull: Një kompani X ka marrë një qira një fushë bakri dhe numri i vlerësuar i njësive në deposite është prej 15,000,000 njësi. Prodhimi për vit është 1,500,000 njësi. Bilanci në llogarinë kapitale në fund të periudhës tatimore është prej 500,000 €. Për të përcaktuar shumën e zhvlerësimit të lejuar për periudhën tatimore, bilanci në llogari duhet të shumëzohet me koeficientin e KA. Në këtë rast, koeficienti është 10% (1,500,000/15,000,000). Kështu zhvlerësimi i lejuar si zbritje është 50,000 €

Për të përcaktuar numrin e vlerësuar total të njësive në deposite, tatimpaguesi duhet të marrë raportin nga ekspertët dhe duhet të vejë në dispozicion për Administratën Tatimore për inspektim nëse kërkohet apo si pjesë e deklaratës tatimore. Llogaritja e njësive të ekstraktit duhet të kryhet duke i shfrytëzuar në mënyrë gjenerale metodat e pranueshme. Administrata Tatimore ruan të drejtën të shfrytëzojë shërbimet e specialistëve të pavarur për të rishikuar raportet e inxhinjeringut dhe metodat e llogaritjes së ekstraktit.

Neni 12

Mbajtja në burim në dividendë, interes, të drejta pronësore dhe qira

Formati i Pasqyrës së Mbajtjes në Burim e Derdhjes së Tatimit mbi Interesat, Dividentin, Qirane, Te Drejtat Pronësore dhe Fitoret në Lotari jepet këtu me poshte:



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOESHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



UNMIK
**PASQYRA MUJORE E MBAJTJES NË BURIM DHE PAGESËS
SË TATIMIT NË INTERES, DIVIDENT, TË DREJTA
PRONËSORE, QIRA DHE FITORE NË LOTARI**

[1] Periudha e Dorëzimit: [1] [2] Nr. Serial: [2]

[3] Numri i Regjistrimit të Mbjajtjesit në Burim: [3]

[4] Emri i mbajtjesit [4]

[5] Adresa e mbajtjesit [5]
(vec nëse ka ndryshuar)

[6] Emri i Personit të Kontaktit [6] Telefon []

[7] Vendos 'X' në kutinë e duhur nëse nuk po e dorëzon për herë të parë për këtë periudhë.
 Shtesë Korrigjim Vetëm pagesë

a. Tatimi i mbajtur në burim në interes, dividendë, të drejta pronësore dhe marrjet ne lotari	Pagesa	Tatimi i mbajtur
[8] Interesi bruto i paguar për muajin	[8]	
[9] Dividenti bruto i paguar për muajin	[9]	
[10] Të drejtat pronësore të paguara për muajin (vetëm jo individeve)	[10]	
[11] Fitoret në lotari bruto të paguara për muajin (vetëm individeve)	[11]	
[12] Shuma totale e paguar për muajin [12=8+9+10+11]	[12]	
[13] Tatimi i mbajtur në burim përveç qirase [13]=[12] x 20%		[13]
b. Tatimi i mbajtur në burim mbi qiratë		
[14] Qiraja bruto e paguar për muajin	[14]	
[15] Tatimi i mbajtur në burim mbi qiratë i paguar [15]=[14] x 16% (vetem qiramarresit jo-individualë)		[15]
[16] Tatimi total i ndalur ne burim [16]=[13]+ [15]		[16]

Unë deklaroj se faktet e raportuara në këtë Pasqyrë janë të vërteta.

Emri/Mbiemri/Nënshkrimi dhe Vula

dd/mm/vv

(_____)

____/____/____

Nënshkrimi dhe vula	Numri i llogarisë: 1000420070000373.	[48]Shuma e tatimit të paguar
Data ____/____/____		

Forma e Çertifikatës të Mbatjes se Tatimit në Burim që do të lëshohet nga agjentët e mbatjes në burim sipas Nenit 27.3 të Rregullores për marrësit e dividendëve, interesit, të drejtave pronësore dhe qirasë është dhënë më poshtë :

Çertifikata e mbatjes në burim të tatimit mbi dividendët, interesin, të drejtat pronësore, fitimet ne lotari dhe qiratë

[1] Emri i paguesit

[2] Numri regjistruar i paguesit

[3] Adresa e paguesit [4] Tel:

[5] Emri i pronarit/drejtorit [6] Tel:

Kjo çertifikatë e mbatjes në burim të tatimit mbi dividendët, interesin, të drejtat pronësore dhe qiratë i lëshohet marrësit pasues:

[7] Emri i marrësit

[8] NP i UNMIK/Numri Individual i Tatimpaguesit

[9] Adresa e marrësit [10] Tel:

Periudha tatimore	Interesi bruto	Dividentët bruto	Të drejtat pronësore bruto (joindividet)	Fitoret në lotari (vetem individet)	Totali I pagesave 6=2+3+4+5	Tatimi i mbajtur në burim në të gjitha pagesat 7=6x20%	Qeraja bruto	Tatimi i mbajtur në burim mbi qiratë (vetem nga qeramarres jo-individuele) 9=8 x 16%
1	2	3	4	5	6	7=6x20%	8	9=8 x 16%

Deklaroj se, me dijen time më të mirë, të dhënat e treguara në këtë Çertifikatë të Mbatjes në Burim të Tatimit janë të vërteta.

Emri, nënshkrimi dhe vula e paguesit/ i personit të caktuar dd/mm/vvvv
 (_____) ____/____/____

Grupat e përjashtuar të specifikuar në nenin 6 të Rregullores do t'i japin evidencë me shkrim mbajtësve në burim të argumentojnë se të ardhurat e tyre janë të përjashtuara dhe kështu nuk i nënshtrohen asnjë mbatje në burim.

Neni 13
Të ardhurat komerciale të OJQ-ve

Neni 29 i Rregullores merret me të ardhurat komerciale të OJQ-ve të regjistruara. Shprehja 'veprimtaria komerciale apo veprimtari tjetër që nuk është ekskluzivisht e lidhur me qëllimin e saj publik' do të ketë kuptimin vijues: Në rastin e një kishe që shet qirinj dhe i shfrytëzon paratë nga shitja për përmirësimin e objekteve që më mirë t'i shërbejnë bashkësisë, veprimtaria e tillë komerciale do të gjykohet të jetë ekskluzivisht e lidhur me qëllimin e përfitimit publik. Në rastin e

një OJQ-je që operon në ngritjen e veprimtarive bujqësore, shitja e farërave dhe rasateve do të gjykohet të jenë ekskluzivisht të lidhura me veprimtarinë primare të përfitimit me kusht që OJQ të përdorë paratë e shitjes mbrenda fushëveprimit të qëllimit të përfitimit publik. Në rast se një OJQ që operon në fushën e shëndetit drejton një kiosk për shtije me pakicë, veprimtaria e tillë komerciale nuk do të gjykohet si ekskluzivisht e lidhur me qëllimin e saj primar të përfitimit publik.

Neni 14

Deklaratat tatimore

Në përputhje me Nenin 30 të Rregullores një deklaratë e tatimit në të ardhurat e korporatave do të dorëzohet në një nga bankat e autorizuara më ose para 1 Prillit të vitit që pason periudhën tatimore. Deklarata tatimore është e përgatitur në tri kopje origjinale. Kopja e parë dhe e dytë mbetet në bankë derisa e treta i kthehet tatimpaguesit pasi të jetë vulosur nga banka. Deklarata tatimore do të konsiderohet si një vlerësim i bërë nga vetë tatimpaguesi. Forma e deklaratës tatimore është dhënë më poshtë:



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOQSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



DEKLARATA E TATIMIT NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE

[1] Periudha tatimore (YYYY)

[2] Nr. serik.: CIT

[3] Numri regjistruer i biznesit

--	--	--	--	--	--	--	--

[4] Emri i tatimpaguesit

--

[5] Adresa e tatimpaguesit
(Nëse ndryshon nga formulari i fundit)

--

[6] Pronari

--

Tel:

--

[7] Menaxheri

--

Tel:

--

[8] Kontabilisti/Mbajtësi i librave

--

Tel:

--

[9] Nëse deklarata tatimore është për të ndryshuar deklaratën e plotësuar më herët për të njëjtën periudhë, vendos 'X' në kutinë që përshkruan llojin e ndryshimit. (Ju lutemi referohuni doracakut)

Shtesë

Korrigjim

Vetëm pagesë

Nënshkrimi dhe vula Data ____/____/____	Numri i llogarisë: 1000420070000373.	[48] Shuma e tatimit të paguar
--	---	--------------------------------

[10] Fitimi neto (humbja) sipas Pasqyrës Financiare

[10]

Rregullimet në të ardhurat

[11]Të Ardhurat me Burim të Huaj (Tabela A)

[11]

[12]Arkëtimi i Borxheve të Këqija (Tabela B)

[12]

[13]Fitimet Kapitale (Tabela C)

[13]

[14]Dividentet (Tabela D)

[14]

[15]Të ardhura/fitime te tjera (Tabela E)

[15]

[16]Rregullimi total në të ardhura (mblidh kutijat 11 deri 15)

[16]

[17]Fitimi (humbja) pas rregullimit në të ardhura (kutia10+/-kutia 16)

[17]

Rregullimet në shpenzime

[18]Shpenzimet e pazbritshme (Tabela F)

[18]

[19]Shpenzimet e përfaqësimit (Tabela G)

[19]

[20]Fondet Rezervë (Tabela H)

[20]

[21]Pagesat për Personat e Lidhur (Tabela I)

[21]

[22]Amortizimi (Tabela J)

[22]

[23]Zhvlerësimi (Tabela K)

[23]

[24]Lejimi special për asetet e reja (Tabela L)

[24]

[25]Humbja kapitale (Tabela C)

[25]

[26]Shpenzime te tjera (Tabela M)

[26]

[27]Rregullimi total në shpenzime (Mblidh kutiat 18 deri 26)

[27]

[28]Fitimi (humbja) e biznesit pas rregullimit në shpenzime (kutia 17 - kutia 27)

[28]

[29]Kontributet Bëmirëse (bashkangjit deftesat)

[29]

[30]Humbjet e mbartura (referoju doracakut)

[30]

[31]Mblidh kutiat 29 dhe 30

[31]

[32]Fitimi i axhustuar perpara aplikimit te koeficientit te rregullimit (kutia 28 - kutia 31)

[32]

[33]Koeficienti i Rregullimit (vetëm OJQ-të)

[33]

[34]Fitimi neto(Humbja) (kutia 32 shumezuar kutia 33)

[34]

Rimbursimi ose Obligimi

[35]Tatimi në fitim (Nese kutia 34 eshte Fitim shumezoje me 20%.Nese kutia 34 eshte Humbje vendos 0)

[35]

[36]Kreditimi tatimor nga shtetet e huaja (Tabela O)

[36]

[37]Tatimi i mbajtur në burim dhe i transferuar per Dividentet, Interesin, të drejtat pronësore dhe Qirane nga paguesit rezident (Tabela P) - bashkangjit certifikatat)

[37]

[38] Këstet e paguara (Tabela Q)

[38]

[39] Totali i krediteve (Mblidh kutitë 36,37 dhe 38)

[39]

[40] Kutia 35 minus kutia 39

[40]

Në qoftë se rezultati në kutinë 40 është pozitiv, ju keni një shume si **OBLIGIM**. Nëse rezultati në kutinë 40 është negativ, ju keni të drejtë për **RIMBURSIM**. Shkruani shumën në kutinë e duhur.

[41] Obligimi

[41]

[42] Rimbursimi

[42]

[43] Emri i bankës

[44] Mbajtësi i llogarisë

[45] Numri i llogarisë

Deklaroj se faktet e raportuara në këtë deklaratë tatimore janë të vërteta.

Emri dhe nënshkrimi i personit të ngarkuar

dd.mm.vvvv

(_____)

____.____.____

Neni 15

Pagesat e tatimit

15.1 Në përputhje me Nenin 31.2 (a) dhe (b) të Rregullores tatimpaguesit me të ardhura bruto më pak se 50,000 euro dhe ata të cilët nuk zgjedhin të përgatisin pasqyrat financiare do të dorëzojnë një Pasqyrë Tremujore të Pagesës Paradhënie në një nga bankat e autorizuar më ose para 15 Prillit, 15 Korrikut, 15 Tetorit dhe 15 Janarit në lidhje me tremujorët kalendarikë që u paraprijnë këtyre datave menjëherë. Pasqyra Tremujore e Paradhënies është përgatitur në tri kopje origjinale. Kopja e parë dhe e dytë mbetet në bankë derisa e treta i kthehet tatimpaguesit pasi të jetë vulosur nga banka. Forma e Pasqyrës Tremujore të Pagesës Paradhënie është dhënë më poshtë:



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



UNMIK

**PASQYRA TREMUJORE E PAGESËS PARADHËNIE PËR
KORPORATAT E VOGLA**

[1] Periudha e deklarimit: [1] [2] Numri serik: [2]AP

[3] Numri i regjistrimit të biznesit [3]

[4] Emri i biznesit [4]

[5] Adresa e biznesit [5]

(Vetëm nëse ndryshon nga formulari i kaluar)

Telefoni

[6] Emri i personit kontaktues [6] Telefoni

[7] Vendos 'X' në kutinë e duhur nëse nuk po dorëzon për herë të parë për këtë periudhë të dorëzimit.

Shtesë Korrigjim Vetëm pagesë

[8] Shitjet bruto për tremujor [8]
(Kjo e dhënë është e përbashkët për të gjitha kategoritë e fituesve të të ardhurave nga biznesi)

I. Tatimpaguesit me arkëtime bruto vjetore më pak se 5,000 euro

[9] Vendos 37,5 euro në kutinë [9]

II. Tatimpaguesit me arkëtime bruto prej 5,000.01-50,000 euro te cilet zgjedhin te paguajne ne „menyre te paragjykuar“. (Nese duan te taten mbi te ardhurat neto duhet te mbushin Pasqyrën Tremujore Paradhënie per Korporatat e Medha)

[10] Paguesa paradhënie [10]=[8] x 3% [10]
(shitje me pakicë, prodhim, tregti, transport, bujqësi, veprimtari tjera komerciale)

[11] Paguesa paradhënie [11]= [8] x 5% [11]
(profesionale, specialitete, zbavitje, veprimtari tjera shërbyese)

III. Tatimpaguesit të cilët realizojnë të Ardhura nga Qiraja

[12] Të ardhurat bruto nga qiraja [12]

[13] Tatimi mbi të ardhurat nga qiraja [13]=[12] x 16% [13]

[14] Tatimi mbi të ardhurat nga qiraja të mbajtur nga të tjerët [14]

[15] Tatimi final mbi të ardhurat nga qiraja [15]=[13]-[14] [15]

[16] Totali i tatimit që do të paguhet me këtë pasqyrë [16]=[9]+[15]ose [10] dhe/ose [11]+[15] [16]

Deklaroj se faktet e raportuar në këtë pasqyrë janë të vërteta.

Emri/Mbiemri/Nënshkrimi dhe vula

dd/mm/vv

()

Nënshkrimi dhe vula

Numri i llogarisë: **1000420070000373.**

[17]Shuma e tatimit të paguar

Data ___/___/___

15.2 Në përputhje me Nenin 31.2.(c) të Rregullores, tatimpaguesit me të ardhura bruto prej 50,000 euro e më tepër dhe ata me të ardhura me të ulta por që zgjedhin të përgatisin pasqyrat financiare kërkohet të dorëzojnë një Pasqyrë Tremujore të Pagesës Paradhënie në një nga bankat e autorizuar më ose para 15 Prillit, 15 Korrikut, 15 Tetorit dhe 15 Janarit në lidhje me tremujorët kalendarik që u paraprijnë këtyre datave menjëherë. Pasqyra Tremujore e Paradhënies është përgatitur në tri kopje origjinale. Kopja e parë dhe e dytë mbetet në bankë derisa e treta i kthehet tatimpaguesit pasi të jetë vulosur nga banka. Forma e Pasqyrës Tremujore të Pagesës Paradhënie është dhënë më poshtë:



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOZHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



UNMIK

**PASQYRA TREMUJORE E PAGESËS PARADHËNIE
PËR KORPORATAT E MËDHA**

[1] Periudha e deklarimit (Q/YYYY)	Numri serik[2]	CIT/LB
---	----------------	--------

[3] Numri i regjistrimit të biznesit	
[4] Emri i biznesit	
[5] Adresa (Vetëm nëse ndryshon nga formulari i kaluar)	
[6] Emri i pronarit	

[7] Vendos 'X' në kutinë e duhur nëse nuk po dorëzon për herë të parë për këtë periudhë të dorëzimit.

Shtesë Korrigjim Vetëm pagesë

• Opcioni A, bazuar në parashikimin e detyrimit tatimor të këtij vitit	Pika	Tatimi
[8] Të ardhurat e parapara për Periudhën Tatimore pjestuar me 4	[8]	
[9] Shpenzimet e parapara për Periudhën Tatimore pjestuar me 4	[9]	
[10] Fitimi i paraparë për periudhën Tatimore pjestuar me 4, [10]=[8]-[9] (Nëse është negative vendos 0)	[10]	
[11] Kësti për tremujor [10] x 20% (Nëse është negative vendos 0)		[11]
• Opcioni B, bazuar në detyrimin tatimor të vitit të mëparshëm		
[12] 110% e detyrimit tatimor të vlerësuar për vitin e kaluar pjestuar me 4	[12]	
[13] Pagesa e këstit që paguhet me këtë formular (Vendos shumën në [11] ose [12])		[13]
[14] Tatimi i mbajtur në burim mbi dividendët, interesin, të drejtat pronësore dhe qiraja nga paguesit rezidente		[14]
[15] Pagesa totale me këtë formular [15]=[13]- [14] (Pjesa vijues të plotësohet vetëm nga Kompanitë e Sigurimeve)		[15]
[16] Primet bruto për tremujor	[16]	
[17] Kësti për tremujor [16] x 7%		[17]
[18] Tatimi i mbajtur në burim mbi dividendët, interesin, të drejtat pronësore dhe qiraja nga paguesit rezidente		[18]
[19] Pagesa totale me këtë formular [19]=[17]- [18]		[19]

Deklaroj se faktet e raportuar në këtë pasqyrë janë të vërteta.

Emri/Mbiemri/Nënshkrimi dhe vula

dd/mm/vv

(.....)

__/__/__

Nënshkrimi dhe vula Data ____/____/____	Numri i llogarisë: 1000420070000373.	[20] Shuma e tatimit të paguar
--	---	--------------------------------

- 15.3 Tatimpaguesit të cilët zgjedhin të paguajnë pagesa paradhënie bazuar në parashikimin e tyre dhe ato pagesa paradhënie rezultojnë të pamjaftueshme krahasuar me detyrimin tatimor final do të ndëshkohen vetëm për tremujorin e fundit të vitit të parë. Për vitin e dytë dhe vitet vijuese pasi që opcioni për të paguar pa ndëshkime dhe interes është në dispozicion ata do të ndëshkohen për secilin këst tremujor nëse janë bërë pagesat e pamjaftueshme gjatë vitit.
- 15.4 Në rastet kur këstet e para janë shumë ta vogla dhe këstet e fundit janë shumë të larta, ndëshkimet do të aplikohen për këstet e para derisa pagesat e tepërta të mëvonshme të kenë mbuluar deficitet. Në rastet kur këstet e para kanë qenë shumë të larta dhe këstet e fundit janë shumë të ulta, ATK do të njohë tepricat në periudhat e para që mbulojnë deficitet në periudhat e fundit dhe ndëshkimet mund ose mund të mos aplikohen varësisht nga shumat e tepricave dhe deficiteve
- 15.5 Aty ku vetëm periudha e fundit e këstit tremujor do të ndëshkohet sipas 15.3 më sipër, atëherë Administrata Tatimore do të konsiderojë dhe ndëshkojë bazuar në shumat e kësteve kumulative krahasuar me detyrimin vjetor, sesa thjesht të merret vetëm kësti i fundit si i izoluar.
- 15.6 Nenin 31.2.c.ii i Regullores i referohet pagesave të bazuara në detyrimin tatimor të vitit të kaluar. Aty ku tatimpaguesi ka humbje tatimore për një vit të veçantë, atëherë duke përdorë bazat e detyrimit tatimor të vitit të kaluar dhe aplikimi e llogaritjes 110% do të nënkuptonte se nuk nevojiten këste në vitin vijues dhe aty ku këstet është dashur të paguhet, nuk do të ketë ndëshkim për nënparashikim për shkak të përdorimit të këtij opcioni.
- 15.7 Tatimpaguesit në vitin e tyre të parë kërkohet të përdorin bazat e parashikimit dhe parashikimet janë të bazuara në $\frac{1}{4}$ e detyrimit tatimor vjetor të parashikuar për vitin e parë. Për ata të cilët fillojnë si tatimpagues gjatë tremujorit të parë kjo nuk është ndonjë problem, por për ata të cilët fillojnë më vonë në vit, ata kërkohet të paguajnë $\frac{3}{4}$, $\frac{1}{2}$ ose vetëm $\frac{1}{4}$ të detyrimit në këste gjatë vitit të parë. Për vitin e dytë, duke paguar në bazë të viti të parë të pjesshëm do të nënkuptojë se nuk do të paguhet ndëshkim për nënparashikim.
- 15.8 Në rastet kur ka pasur një kontrollë në vitin vijues që përcakton një detyrim tatimor vjetor tjetër për një vit të mëparshëm tatimor, nëse detyrimi vjetor tatimor është gjetur të jetë i lartë, ndëshkimet do të aplikoheshin për nëndeklarim, për pagesë me vonesë dhe poashtu interes për detyrimin vjetor të paguar më pak. Ndëshkimet e tilla dhe interesi për detyrimin tatimor shtesë të gjetur si rrjedhojë e kontrollit do të aplikohen vetëm në detyrimin tatimor vjetor, dhe nuk do të bëhet rregullim në shumat e kësteve të kaluara tremujore.
- 15.9 Formulari vjetor i tatimit në të ardhurat e korporatave është një deklaratë tatimore por pasqyrat e pagesës paradhënie nuk do të gjykohen si deklarata tatimore. Ndëshkimi për deklaram me vonesë nuk do të aplikohet mbi formularët e kësteve tremujore që dorëzohen me vonesë, por ndëshkimet dhe interesi për pagesë me vonesë do të aplikohen.

Neni 16

Librat dhe regjistrimet

Tatimpaguesit me të ardhura vejtore bruto prej 50,000 euro ose më tepër dhe ata me të ardhura vejtore bruto prej 5,000-50,000 euro të cilët vendosin të taten në fitimin real do të mbajnë

librat dhe regjistrimet vijuese: libër të shitjes, libër të blerjes, libër të shpenzimeve dhe libër të llogarisë së kapitalit ku do të regjistrohen të gjithë artikujt e të ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto prej 5,000-50,000 euro do të mbajnë një libër të shitjes dhe një libër të blerjes. Tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto prej 5,000 euro a më pak do të mbajnë një libër ditor të keshit (parave të gatshme). Tri kategoritë e tatimpaguesve të cekur më lart kërkohet të lëshojnë fatura/kupona për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të kryera nga ata.

Neni 17

Aplikimi për t'u regjistruar

Administrata Tatimore do të shfrytëzojë regjistrimet e saja të krijuara për administrimin e Tatimit të Paragjykuar dhe Tatimit në Fitim për të administruar tatimin e ri Tatimin në të Ardhurat e Korporatave. Bazuar në këto regjistrime secili biznes ekzistues i inkorporuar do të caktohet në një regjim tatimor, ose në atë të paragjykuar ose në atë real. Barra për të argumentuar se një vendim i Administratës Tatimore për caktimin e një tatimpaguesi në njërin apo kategorinë tjetër të përmendur në nenin 16 është gabim bie mbi tatimpaguesin. Tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto në mes 5,000 dhe 50,000 euro mundën të zgjedhin që të taten sipas skemës së tatuarjes të të ardhurave reale në vend të skemës së tatuarjes në mënyrën e paragjykuar. Këta tatimpagues mund ta bëjnë këtë duke plotësuar një formular aplikacioni dhe ta dorëzojnë atë në Administratën Tatimore. Format i formularit të aplikacionit është dhënë më poshtë:



UNMIK

**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA**

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



**FORMULAR APLIKACIONI PËR REGJISTRIM PËR KORPORATAT E VOGLA QË
VENDOSIN TË TATOHEN SIPAS SKEMËS SË TATUARJES MBI TË ARDHURAT
REALE**

[1] Emri i tatimpaguesit	
[2] Numri i regjistrimit të Biznesit	
[3] Adresa e tatimpaguesit	
[4] Numri i telefonit të tatimpaguesit	
[5] Të ardhurat bruto për periudhën e kaluar tatimore	
[6] Të ardhurat bruto të parashikuara për periudhën e tanishme tatimore	

Me këtë vendos të regjistrohem sipas skemës së tatuarjes mbi të ardhurat reale. E kuptoj se duke e bërë këtë nga unë kërkohet të mbaj libra dhe regjistrime të duhura dhe të dorëzojë një deklaratë tatimore vjetore për secilën periudhë tatimore që vjen dhe nuk më lejohet të dalë nga ky regjim dhe t'i kthehem skemës së tatuarjes në mënyrën e paragjykuar.

Emri, Mbiemri dhe Nënshkrimi I personit të caktuar
(_____)

dd/mm/vvvv

____/____/____

Neni 18

Ortakët dhe ortakëritë

Ortakët e inkorporuar që marrin hise fitimi nga ortakëria do të konsolidojnë një të ardhur të tillë dhe do t'i nënshtrohen Tatimit në të Ardhurat e Korporatave. Vetë Ortakëria do të mbajë libra dhe regjistrime, do të regjistrohet për TVSh, nëse ky është rasti, do të dorëzojë deklaratën e TVSh-së dhe të paguajë detyrimin e TVSh-së duke përdorë Numrin e Regjistrimit e Biznesit të lëshuar nga regjistri i biznesit. Ortakëria do të duhet të dorëzojë një pasqyrë vjetore barazimi për qëllime të tatimit në të ardhurat e korporatave por nuk do të bëjë pagesë të detyrimit tatimor. Ortakët do të duhet të dorëzojnë pasqyrat tremujore të të ardhurave dhe të bëjnë pagesat tremujore paradhënie në lidhje me kontributin e tyre në ortakëri dhe poashtu të dorëzojnë deklaratën e barazimit për periudhën tatimore dhe të paguajnë çdo tatim obligim ose të kërkojnë çdo rimbursim për tatimin e paguar tepër.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi në të njëjtën ditë kur edhe Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/51 'Mbi Tatimin në të Ardhura të Korporatave'.

Haki Shatri

Ministër i Financave dhe Ekonomisë

